



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 647/18 Prot

Tiranë, më 17/7/2020

VENDIM

Nr. 23, datë 17.7.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr.647, Prot., datë 08.06.2020, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Bankës së Shqipërisë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 25.05.2020, depozituar në adresën e koordinatorit [nsamarxhiu@bankofalbania.org](mailto:nsamarxhiu@bankofalbania.org), ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni, në lidhje me praktikën e plotë të blerjes dhe më pas të rikonstruksionit të ish-Hotel Dajtit nga Banka e Shqipërisë, duke përfshirë dokumentacionin e disponueshëm, si vijon:

1. *Kopje të procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë gjatë miratimit të projektvendimit për blerjen e ish-Hotel Dajtit.*
2. *Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e procedurës me prokurim të drejtpërdrejtë për blerjen e pronës së paluajtshme shtetërore ish-Hotel Dajti.*

3. Një kopje të procesverbaleve të diskutimeve mes përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë dhe qeverisë shqiptare për blerjen e pronës së paluajtshme shtetërore ish-Hotel Dajti.
4. Dokumente të tjera në lidhje me blerjen e ish-Hotel Dajtit, si: analiza, relacione, etj.
5. Një kopje të projektit për rikonstruksionin e ish-Hotel Dajtit.
6. Praktika e përzgjedhjes së projektuesit, projektuesi i kontraktuar, kostoja financiare dhe lloji i procedurës së ndjekur.
7. Një kopje e studimit të parë të projektuesit për ndërtesën.
8. Një kopje e studimit të dytë të projektuesit për ndërtesën.
9. Një kopje e preventivit të zbatimit për rikonstruksionin e ndërtesës së ish - Hotel Dajti.
10. Shuma totale financiare miratuar për rikonstruksionin nga viti 2010 deri në vitin 2020.
11. Kompania e kontraktuar për rikonstruksionin e ish-Hotel Dajtit, fondi limit dhe oferta fituese.
12. Një kopje të kontratës me subjektin e kontraktuar për rikonstruksionin e ish - Hotel Dajtit.
13. Një kopje e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës për kohëzgjatjen e kontratës për zbatimin e rikonstruksionit të ish - Hotel Dajtit.
14. Një kopje e përgjigjeve të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Këshillit Kombëtar të Restaurimeve për projektin e rikonstruksionit të ish - Hotel Dajtit.
15. Një kopje të lejes së Këshillit Kombëtar të Territorit për rikonstruksionin e ish - Hotel Dajtit.
16. Shpenzimet për prishjet në godinën e ish - Hotel Dajtit, subjekti i kontraktuar, një kopje e kontratës dhe të dokumenteve për zbatimin e saj.
17. Në çfarë faze është sot rikonstruksioni i ish - Hotel Dajtit?
18. Sa është kostoja e pagesave të Bankës së Shqipërisë për marrjen e ambienteve me qira për nevojat e saj nga viti 2010 deri në vitin 2020?
19. Emrat e subjekteve me të cilët Banka e Shqipërisë ka lidhur kontrata qiraje.
20. Çfarë ambienteve ka marrë aktualisht Banka e Shqipërisë me qira dhe sa është kostoja e tyre?

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it të datës 28.05.2020 ka kthyer përgjigje, duke informuar kërkuesin ndër të tjerat se: "...Në bazë të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 40, datë 16.06.2010 "Për miratimin e procedurës së prokurimit të drejtëpërdrejtë për blerjen e pasurisë së paluajtshme shtetërore "ish – hotel Dajti" nga Banka e Shqipërisë", kjo godinë është në pronësi të Bankës së Shqipërisë. Informacioni i bërë publik në lidhje me rikonstruksionin e ish - hotel Dajtit mund të aksesohet në faqen zyrtare të Bankës në linkun:[https://bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet\\_per\\_shtyp/Sqarim\\_per publikun\\_Mb\\_i\\_rikonstruksionin\\_e\\_ish-hotel\\_Dajtit.html](https://bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet_per_shtyp/Sqarim_per publikun_Mb_i_rikonstruksionin_e_ish-hotel_Dajtit.html)".

Ndërkohë Autoriteti Publik ka refuzuar të vendosë në dispozicion dokumentacionin në lidhje me prokurimet publike të realizuara për rikonstruksionin e ndërtesës me argumentin se: *“...dosjet e prokurimit në Bankën e Shqipërisë janë të klasifikuara si “Sekret bankar” dhe si rrjedhojë duke ju nënshtruar udhëzimit për “Sekretin bankar” personat që mund të njihen duhet të kalojnë përmes një procedure të caktuar”*.

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se: *“Autoriteti Publik ka refuzuar dhënien e informacionit të kërkuar duke devijuar dhe anashkaluar pikat e kërkesës nuk ka vënë dispozicion asnjë kopje dokumentit të kërkuar...”,* i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “Ligji nr. 119/2014”) dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”,* dhe nenin 31/1c të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Komisioneri me Urdhrin nr. 107, datë 12.06.2020, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në kthim përgjigjen e datës 28.05.2020, si dhe plotësuan argumentin si më poshtë:

*“Në lidhje me pjesën e informacionit që lidhet me kopje të vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë mbi çështje të buxhetit apo të rikonstruksionit të ish - hotel Dajtit, sillat në vëmendje që Këshilli Mbikëqyrës (në vijim “KM”), si organi më i lartë vendimmarrës, përcakton gjatë shqyrtimit të projekteve nëse vendimet përkatëse, ose një pjesë e tyre, do të bëhen publike, bazuar në parashikimet e nenit 50 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, procedurat dhe rezultatet e mbledhjes së KM janë konfidenciale. KM mund të vendosë për të bërë të njohura publikisht një pjesë ose të gjitha vendimet e tij.*

*Në lidhje me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 40, datë 16.06.2010 “Për miratimin e procedurës me prokurim të drejtpërdrejtë për blerjen e pronës së paluajtshme shtetërore ish-Hotel Dajti”, për të cilin KM ka vendosur*

*publikimin e tij, një kopje të këtij vendimi po e vendosim në dispozicion të përfaqësuesëve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Gjithashtu ai mund të gjendet edhe në linkun vijues:*

*[https://bankofalbania.org/Botime/Botime\\_Periodike/Buletini\\_Zyrtar/Buletini\\_Zyrtar-Vellimi\\_12\\_nr\\_5.html\(faqe\\_8\)](https://bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Buletini_Zyrtar/Buletini_Zyrtar-Vellimi_12_nr_5.html(faqe_8))*

*Në lidhje me kërkesat e tjera për dokumentacion, konkretisht për ato të prodhuara nga BSH, sqarojmë se ato lidhen me vendimmarrje të KM të cilat bazuar në parashikimet e nenit 50 të ligjit organik të BSH janë konfidenciale”.*

Pas administrimit të argumentave të parashtruara nga përfaqësuesit e Autoritetit Publik, grupi i inspektimit kërkoi të informohet lidhur me disponimin e informacionit të kërkuar, objekt i urdhrit të inspektimit.

Në përfundim, grupi i inspektimit nuk mundi të verifikojë faktet lidhur me objektin e ankimit. Nuk u arrit të administrohen provat që vërtetojnë pretendimet e autoritetit, për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga përfaqësuesit e Autoritetit Publik.

Bazuar në nenet 53, 91 dhe 92 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri me Vendimin nr. 647/3 Prot., datë 29.06.2020 “Për zgjatjen e afatit të procedurës administrative”, vendosi shtryrjen e afatit të përfundimit të procedurës deri me datë 20.07.2020.

Në vijim, me shkresën nr. 647/6 Prot., datë 03.07.2020, Zyra e Komisionerit ka dërguar procesverbalin e mbajtur nga grupi i inspektimit pranë Autoritetit Publik, pas refuzimit të nënshkrimit nga përfaqësuesit e këtij të fundit.

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të Ligjit nr. 119/2014, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore me palët.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 13.07.2020, në mungesë të ankuesit, i cili kishte marrë dijëni rregullisht për datën dhe orën e seancës, por nuk u paraqit për arsye personale. Pavarësisht mosprezencës, ankuesi konfirmoi qëndrimin e mbajtur në ankim ndaj përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik. Ndërkohë, Autoriteti Publik u përfaqësua në seancë nga znj. Najada Samarxhiu, koordinator i së drejtës për informim pranë Autoritetit Publik, znj. Alba Fagu, znj. Jurida Dimroçi dhe z. Elis Metaj, pajisur me autorizimin nr. 3195 Prot., datë 09.07.2020.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Autoritetit Publik parashtruan të njëjtin qëndrim, me atë të mbajtur në përgjigjen e kthyer për kërkuesin në datë 28.05.2020 si

dhe gjatë zhvillimit të inspektimit. Gjithashtu, vendosën në dispozicion të Komisionerit, dokumentet si vijon:

- *Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 18, datë 10.03.2010 "Për një ndryshim në Vendimin "Për miratimin e përdorimit të procedurës së prokurimit të drejtëpërdrejtë për blerjen dhe marrjen me qira të ambienteve të reja për nevojat e Bankës së Shqipërisë"*,
- *Vendimin nr. 85, datë 13.12.2010 "Për miratimin e procedurës së veçantë të prokurimit për realizimin e përshtatjes së pjeshme të godinës së ish-Hotel Dajtit"*,
- *Vendimin nr. 55, datë 27.07.2011 "Për miratimin e procedurës së veçantë të prokurimit për realizimin e projektzbatimit të rikonstruksionit të ndërtesës së ish - Hotel Dajtit"*.
- *Vendimin nr. 27, datë 01.04.2015 "Për miratimin e realizimit të objektit të prokurimit "Rikonstruksioni i godinës së ish - Hotel Dajtit" nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje deri në 3 vjet.*
- *Vendimin nr. 53, datë 06.09.2017 "Për miratimin e realizimit të objektit të prokurimit "Mbikëqyrja e punimeve për rikonstruksionin e Godinës së ish - Hotel Dajtit" nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje deri në 3 vjet".*

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri i kërkoi përfaqësuesve të Autoritetit Publik për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur, si dhe për t'u shprehur në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar. Afati i vendosur për kthimin e përgjigjes u caktua brenda datës 15.07.2020.

Në vijim, Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 15.07.2020, ka rikonfirmuar qëndrimin si më sipër duke shtuar gjithashtu se: *"...Nga referenca e përdorur në ankimin e z. Doci pranë Komisionerit e cila referon legjislacionin për prokurimet publike, sqarohet se sipas ligjit për Bankën e Shqipërisë (neni 76), Banka është e përjashtuar nga përcaktimet e këtij dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Banka e Shqipërisë operon nëpërmjet Rregullores "Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë", miratuar me Vendimin nr. 81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar, një kopje e së cilës është e aksesueshme në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë: [https://www.bankofalbania.org/Rreth\\_Bankes/Legjislacioni/Rregullore\\_Nr\\_81\\_Per\\_procedurat\\_e\\_prokurimit\\_ne\\_Banken\\_e\\_Shqiperise.html](https://www.bankofalbania.org/Rreth_Bankes/Legjislacioni/Rregullore_Nr_81_Per_procedurat_e_prokurimit_ne_Banken_e_Shqiperise.html)*

Gjithashtu, bashkëlidhur ka vendosur në dispozicion përveç vendimeve të paraqitura në seancë dëgjimore edhe Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.40, datë 16.06.2010 "Për miratimin e procedurës me prokurim të drejtëpërdrejtë për blerjen e pronës së paluajtshme shtetërore ish-Hotel Dajti".

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: *“Banka e Shqipërisë është e përjashtuar nga përcaktimet e legjislacionit për prokurimet publike dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pasi operon nëpërmjet Rregullores “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me Vendimin nr. 81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar”, Komisioneri vlerëson se përjashtimi i Autoritetit Publik nga zbatimi i ligjit për prokurimin publik, nuk passjell përjashtimin e këtij autoriteti nga zbatimi i Ligjit nr. 119/2014.*

Në nenin 2, të Ligjit nr. 119/2014 parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuptim të këtij parashikimi, Banka e Shqipërisë është autoritet publik dhe subjekti i Ligjit nr. 119/2014, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Ndërkohë, bazuar në pikën 2, të neni 2 të Ligjit nr. 119/2014 *“Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”, Komisioneri vlerëson se dokumentet të cilat prodhohen apo disponohen nga ana e Autoritetit Publik, përbëjnë informacion publik dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara duhet të vendosen në dispozicion, duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të Ligjit nr.119/2014.*

Gjithashtu konstatohet se, fillimisht Autoriteti Publik në përgjigjen e datës 28.05.2020, mban qëndrimin se *“dosjet e prokurimit në Bankën e Shqipërisë janë të klasifikuara si “Sekret bankar” dhe rrjedhimisht duke ju nënshtruar udhëzimit për “Sekretin bankar” personat që mund të njihen duhet të kalojnë përmes një procedure të caktuar”.*

Në lidhje me këtë qëndrim, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk është i bazuar në ligj.

Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 *“Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe gjithë kuadri nënligjor i dalë në zbatim të tij, nuk parashikojnë klasifikimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, të zhvilluara nga Autoriteti Publik, si “Sekret Bankar”. Për më tepër, vetë terminologjia “Sekret Bankar”, e përdorur nga Autoriteti Publik, nuk gjen rregullim të posaçëm nga kuadri rregullator i sipërcituar.*

Procedurat e prokurimit të Autoriteti Publik zhvillohen në përputhje me *“Rregulloren për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me Vendimin nr. 81, datë 15.11.2006, i ndryshuar, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.*

Në nenin 2 të Rregullores së sipërcituar parashikohen parimet kryesore mbi bazën e të cilave kryhen procedurat e prokurimit nga Autoriteti Publik. Në pikën “d” të këtij neni

parashikohet parimi i sigurimit të ndershmërisë, besimit të publikut dhe të arritjes së transparencës në procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”.

Në asnjë dispozitë të Rregullores nuk parashikohet klasifikimi si sekret bankar i dosjeve të procedurave të prokurimit publik.

Në nenin 37 të Rregullores, parashikohet se: “Pas hapjes së ofertave, informacionet në lidhje me shqyrtimin, me sqarimin dhe me vlerësimin e ofertave dhe rekomandimet për ofertën fituese janë konfidenciale dhe nuk duhet t’u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces, derisa të lidhet kontrata”. Për rrjedhojë, edhe nëse do të ishim përpara rastit të kufizimit të dhënies së informacionit mbi bazën e konfidencialitetit, ky kufizim gjen zbatim deri në momentin e lidhjes së kontratës.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri gjen të pabazuar dhe në kundërshtim me Rregulloren për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë, argumentin e dhënë nga Autoriteti Publik për mosdhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Për sa i përket argumentit tjetër të Autoritetit Publik, se: “Informacioni në lidhje me rikonstruksionin e ish hotel Dajtit është bërë publik dhe mund të aksesohet në faqen zyrtare të Bankës në linkun:

[https://bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet\\_per\\_shtyp/Sqarim\\_per\\_publicun\\_Mbi\\_rikonstruksionin\\_e\\_ish-hotel\\_Dajtit.html](https://bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet_per_shtyp/Sqarim_per_publicun_Mbi_rikonstruksionin_e_ish-hotel_Dajtit.html), Komisioneri vlerëson se edhe ky argument nuk qëndron. Kërkesa për informacion e ankuesit konsiston në vënien në dispozicion të dokumenteve konkretë si kontratë, procesverbale, studim prejktuesi, leje, etj., dhe jo një informacion të përgjithshëm në lidhje me rikonstruksionin e objektit në fjalë.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: “Bazuar në parashikimet e nenit 50 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, procedurat dhe rezultatet e mbledhjes së KM janë konfidenciale dhe KM mund të vendosë për të bërë të njohura publikisht një pjesë ose të gjitha vendimet e tij”, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik nuk arriti të provoj apo të vendosi në dispozicion asnjë dokument ku të pasqyrohet vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës për t’i bërë publike apo jo këto dokumente.

Megjithëse në pikën 4 të Urdhrit nr. 107, datë 12.06.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, citohet se: “Nga autoriteti publik të bashkëpunohet për krijimin e kushteve normale për zhvillimin e kontrollit si vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshëm dhe punonjësit përgjegjës”, këto dokumente nuk u vendosën në dispozicion të grupit të inspektimit gjatë hetimit administrativ.

Nga ana e Autoritetit Publik citohet vetëm pika 1 e nenit 50 i Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, si një parim i përgjithshëm, në të cilin parashikohet se: “1. Procedurat dhe rezultatet e Mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës janë konfidenciale. Këshilli Mbikëqyrës mund të vendosë për të bërë të njohura publikisht një pjesë ose të gjitha vendimet e tij.”

Pavarësisht sa më sipër, edhe nëse dispozita do të lexohej sipas këndvështrimit të Autoritetit Publik, ky i fundit duhet të kishte mbajtur në konsideratë pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014, sipas së cilës *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*, dhe jo të refuzonte në tërësi pa argumentimin përkatës dhënien e informacionit.

Si përfundim, nga verifikimi i kërkesës për informacion të datës 25.05.2020 si dhe qëndrimin të Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se kërkesat në lidhje me pikat 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 konsiderohen të papërbushura.

Në lidhje me pikën 2 të kërkesës për informacion, Komisioneri konstaton se Autoriteti Publik ka informuar kërkuarin me kthim përgjigjen datë 28.05.2020 se kjo procedurë është bërë në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.40, datë 16.06.2010 *“Për miratimin e procedurës së prokurimit të drejtëpërdrejtë për blerjen e pasurisë së paluajtshme shtetërore “ish – hotel Dajti” nga Banka e Shqipërisë”*, por nuk ka vendosur në dispozicion të ankuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni, në kundërshtim kjo me pikën 2 të nenit 16 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”* në të cilin parashikohet se: *“Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuarit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni... ”*. Rrjedhimisht, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur pjesërisht.

Gjithashtu, nga verifikimi i linkut:

[https://bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet\\_per\\_shtyp/Sqarim\\_per publikun\\_Mbi\\_rikonstruksionin\\_e\\_ish-hotel\\_Dajtit.html](https://bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet_per_shtyp/Sqarim_per publikun_Mbi_rikonstruksionin_e_ish-hotel_Dajtit.html), rezulton i publikuar pjesërisht informacioni në lidhje me pikën 10, pasi kërkesa konsiston në *“Shumën totale financiare miratuar për rikonstruksionin nga viti 2010 deri në vitin 2020”*, ndërkohë informacioni i publikuar është i përditësuar deri në vitin 2018.

Rrjedhimisht, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur pjesërisht.

Në lidhje me pikën 13 të kërkesës për informacion, konstatohet se, megjithëse Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion të Komisionerit gjatë seancës dëgjimore Vendimin nr. 27, datë 01.04.2015 *“Për miratimin e realizimit të objektit të prokurimit “Rikonstruksioni i godinës së ish hotel Dajtit nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje deri në 3 vjet”*, nuk ka informuar Ankuesin apo vendosur në dispozicion të tij linkun përkatës në të cilën është publikuar ky dokument. Rrjedhimisht edhe kjo kërkesë konsiderohet e papërbushur.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjisllacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014.



E drejta për informimin, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t'i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe për ti shërbyer nxitjes së integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e Ligjit nr. 119/2014 parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri, vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të ankuesit, dokumentacionin sipas kërkesës së datës 25.05.2020.

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni i shqyrtuar dhe përmendur më sipër, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik duhet të ketë në vëmendje nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014.

Ndërkohë në pikën 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 119/2014, parashikohet se mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative. Në pikën 2 të nenit 18 parashikohet se veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre është në interesin publik.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 647 Prot., datë 08.06.2020 të z. Adriatik Doçi, kundër Autoritetit Publik “Bankës së Shqipërisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës datë 25.05.2020, brenda datës 24 . 7 .2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 17 . 7 .2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

